



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 12782 Prot.

Lezhë, më 02 .02 .2021

VENDIM

Nr. 105 Datë 29.06 .2021

Për

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës të shtetasit Endrit Rexhep Curaj, banor në Ishull-Shëngjin, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", të VKM Nr.329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njëzore", pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile ,mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Z.Endrit Rexhep Curaj, banor në Ishull-Shëngjin, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1.Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetasit Z.Endrit Rexhep Curaj për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.

A.Të miratojë dëmin e shkaktuar nga zjarri në vlerën	1312985 lekë.
a) Dëmi i shkaktuar në ndërtesë	1077985 lekë.
b) Dëmi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje	235000 lekë. .

B. Mbështetur në VKM. Nr 329 dt.16.05.2012, kap3, pika 3, gërmat b e ç, kompensimi për dëmin e shkaktuar në anën ndërtimore të jetë në masën 50%, ndërsa kompensimi për dëmin e shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje, mbështetur në kap 3, pika 3 gërma d të VKM-së së mësipërme të jetë sa masa e dëmit të shkaktuar dhe konkretisht :

a) Vlera e kompensimit të dëmit në anën ndërtimore të jetë	538992 lekë.
b) Vlera e kompensimit të dëmit në orendi, mobilje e pajisje	235000 lekë.
Vlera totale	773992 lekë.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.

3. Bashkia Lezhë t'i akordojë familjes së shtetasit Z.Endrit Rexhep Curaj me Nr.ID. J30915043F ndihmën emergjente në vlerën prej 773992 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave

Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2021, bazuar në VKM nr.329 dt.16.05.2012.

4. Ndhima financiare që do t'i akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Z Endrit Rexhep Curaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri.

5.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
ERNEST RAKAJ

